

“KRITIKA E MORALIT NGA FRIEDRICH NIETZSCHE”

MASTER I ARTEVE NË FILOZOFI

NGA

EDONA ZEJNULLAHU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I FILOZOFISË

Prishtinë

Maj, 2022

EKSPOZË E TEMËS:

“KRITIKA E MORALIT NGA FRIEDRICH NIETZSCHE”

Edona Zejnullahu

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Astrit Salihu

Qëllimi im në këtë temë diplome nuk është vetëm që të paraqes mënyren se si Nietzsche e kritikon moralin, por përmes asaj kritike se si me Nietzsche-n vijmë deri te një interpretim krejtësisht i ndryshëm dhe një interpretim i ri për botën. Siç e dimë me Nietzschen kemi riorientime të mëdha në filozofi, mendime të reja, nocione të reja siç janë: afirmimi i jetës, mbinjeriu, vullneti për pushtet etj. Deri më sot kemi pasur mendime e interpretime të ndryshme për botën nga filozof të ndryshëm, por ajo që Nietzsche e mer për bazë në filozofinë e tij, është ai kanoni sokratiko-platonik. Ai siç e dimë fillon me kritikën e metafizikës perëndimore me atë kanonin sokratiko-platonik, sepse aty sipas tij fillon e keqja, aty e kemi ndarjen e botës në botën reale dhe atë ideale. Ai kritikon moralin, religjionin dhe arsyeja e vetme pra pse ai bënë këto kritika është pikërisht vet jeta. Sipas Nietzsche-s me Platonin vjen e keqja dhe më e keqja është ajo ndarja e botës, që pastaj kjo ka të bëjë edhe me ndarjen e truporës nga shpirtërorja dhe në fund kemi të bëjmë me vdekjen e Zotit, siç e shprehë ai me një metaforë se duhet te vdesë Zoti që të çlirohet njeriu. Poashtu ai na flet për faktin se njeriu modern nuk ka më nevojë për një Zot si themel i parë i botës. Njeriu është në qendër të botës, është vendimtari, ai i cili i vendos vlerat, Zarathustra thotë se të gjithë zotrat janë të vdekur dhe ne duam që mbinjeriu të krijohet dhe të jetojë. Kështu arrijmë deri te koncepti tjetër mjaft i rëndësishëm për Nietzsche-n, e që është vullneti për fuqi, i cili ka të bëjë me të ardhmën, e do atë që vjen, që është e mundshme. Pra, Nietzsche kritikon metafizikën, moralin, krishtërizmin sepse sipas tij ato janë mohuese të jetës, ne duhet ta pranojmë jetën ashtu siç është. Me Nietzschen i themi po jetës, kemi afirmimin për jetën si koncept esencial në filozofinë e tij.